

## Trajtimi i Përpjekjeve për të Heshtur Gazetaret Gra në Internet

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme në një aktivitet për Sigurinë e Gazetareve Gra në Internet (SOFJO) të Hënën, **11 tetor 2021, ora 15.15-16.45** (Ora e Evropës Qendrore) në kuadër të Konferencës për Median në Evropën Juglindore (SEEMC).

Gazetaret gra sulmohen në internet më shpesh dhe në rrafsh më personal dhe seksual se sa kolegët burra, me qëllimin e qartë për t'u dëmtuar reputacionin dhe për të heshtur zërat e tyre. Abuzimi me baza gjinore në internet minon të gjitha perspektivat për liri të medias të diskutuara në Konferencën e sivjetshme për Median në Evropën Juglindore, shpesh është pjesë e fushatave të dezinformimit dhe bëhet rregullisht edhe jashtë internetit. Të kuptuarit se si të zhbëjmë sulmet në internet ndihmon të gjithë gazetarët në secilin mjedis qofshin.

Konferenca SEEMC e sivjetshme do të përmbajë një aktivitet anësor të posaçëm për prezantimin e [Udhëzuesit të Burimeve #SOFJO](#) në disa gjuhë. Ky Udhëzues propozon disa veprime për dhjetë grupe kyçe aktorësh për trajtimin e abuzimit me baza gjinore të gazetareve në internet. Ai evidenton rrugën për t'u ndjekur dhe radhit burime të dobishme dhe shembuj të praktikave të mira. Udhëzuesi është i gjindshëm në Shqip, Maqedonisht, Serbisht, Anglisht dhe Rusisht.

Aktiviteti anësor do të përmbajë ekspertë të fushës dhe do të lidhet me secilën prej katër temave të SEEMC për të diskutuar veprimet konkrete që nevojiten në kontekstin e dezinformimit dhe kushteve të punës së gazetareve, për të fuqizuar gazetaret gra dhe për t'u garantuar siguri ligjore. Te gjitha aspektet do të diskutohen nga pikëpamje ndërsektoriale dhe nga pikëpamja e të rinjve, si dhe do të përpunohen veprime në bazë të propozimeve të Udhëzuesit të Burimeve #SOFJO. Për çdo pyetje, ju lutemi të kontaktoni [Julia.Haas@osce.org](mailto:Julia.Haas@osce.org).

Presim me padurim t'ju takojmë në aktivitetin anësor për sigurinë e grave gazetare në internet!

### Folësit

- **Aleksandra Bogdani**, Gazetare Hulumtuese, Balkan Insight, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese/BIRN
- **Ricardo Gutierrez**, Sekretar i Përgjithshëm, FEG
- **Veljko Milić**, Jurist, Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës
- **Borka Rudić**, Sekretare e Përgjithshme e Shoqatës së Gazetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës
- **Milka Tadić-Mijović**, Drejtoreshë, Qendra për Raportimin Hulumtues

### Moderatore

- **Julia Haas**, Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias

